



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RETHIT ELBASAN
NR.776 R.TH.A-PENAL DT.27.6.2014
NR.776 I VENDIMIT DATE 27.6.2014

V E N D I M
" PER SHQYRTIMIN E KERKESES PER VENDOSJE MASE SIGURIMI
PASUROR "

Gjykata e rrethit Elbasan e perbere prej :
GJYQTARIT ILIR PASHAJ,

Asistuar prej sekretares Jorna Santo , ne Elbasan, me daten 27.6.2014 shqyrtoi ne seance gjyqesore ceshtjen penale qe i perket kerkeses se paraitur prej :

PROKURORISE SE RRETHIT ELBASAN , e perfaqesuar prej prokurorit
Kreshnik Ajazi,

ME OBJEKT : Vendosjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros preventive te llogarive bankare.

BAZA LIGJORE : Nenet 274 i K.P.Penale.

Ne perfundim te gjykimit, pas degjimit te relacionit te prokurorit, administrimit te provave te nevojshme , si u degjua prokurori Kresgnik Ajazi qe kerkoi pranimin e kerkeses,Gjykata si shqyrtoi provat dhe ceshtjen ne teresi ,

V E R E N :

Prokuroria e rrethit Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr.1547 te vitit 2014 per vepren penale "pastrimi i produkteve te vepores penale dhe veprimtarise kriminale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal, ne ngarkim te shtetasit Adhurim Selmani, biri i Gafur dhe Qanije, dtl.1973,lindur ne Maqellare , Diber dhe banues ne Lagje "Beqir Dardha",rruga "Refik Serica", pallati 77, i martuar, me kombesi e shtetesi shqiptare.

Sa relatohet nga kerkesa e prokurorit, Adhurim Selmani ne daten 18.6.2014 ka marre ne llogarine e tij bankare ne Banken Kombetare Tregetare (te celur prej tij ne maj 2014) nje shume te hollash prej 25000 paund britanike me transferues te hollash shtetasin e huaj Omar Mohammed Khan, i perfshire ne veprimtari terroriste ne shtetin anglez, transaksion pa specifikime per aresyet e dergeses, pra transaksion i dyshuar prej burimeve te dyshimta.

Ne keto kushte prokurori aresyeton se eshte e nevojshme te vendoset masa e sigurimit pasuror e sekustros preventive mbi llogarite bankare te Adhurim Selmani p[rane B.K.Tregetare , pasi sipas prokurorit lenia e lire e transaksioneve mbi keto llogari

Ne keto kushte kerkesa e prokurorit nuk gjendet e bazuar ne nenin 36 te K.Penal dhe 274 te K.P.Penale.

PER KETO ARESYE,

Gjykata ne baze te nenit 274 e vijim te K.P.Penale,

VENDOSI:

I.Rrezimin e kerkeses.

Kunder vendimit lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Durres brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes .Per personat e interesuar ky afat nis nga e nesermja e komunikimit te ketij vendimi.

U shpall ne Elbasan me daten 27.6.2014.

SEKRETARE

Jorna Santo




GJYQTARI

ILIR PASHAJ



Vërtetohet se ky vendim
ka marrë fuqinë të prerë
me datë 27/07/14
K/S Kancelares



Gjykata e Rrethit Gjyqësor
Elbasan
Vërtetohet se ky akt është i njëjti
me origjinalin që gjodhet në
Kiv D. 23/11/2014